



CIMC- 2006/4
28 gusht 2006

Draft

Udhëzimet e KPM-së në Zbatimin e Sanksioneve ndaj të Licencuarve

1.0 Qëllimi: Qëllimi i këtyre udhëzimeve është të definoj politikat e KPM-së në vënien e sanksioneve për shkelje të Rregulloreve të KPM-së, pas konfirmimit të këtyre shkeljeve në përputhje me rregullat e procedurës së KPM-së.

2.0 Përkufizimet:

2.1 Rregullore: “Rregullore” do të thotë kushtet dhe konditat e përgjithshme dhe specifike të licencës së Komisionerit të Përkohshëm për Media/Komisioni i Pavarur për Media; kodet të zbatueshme ndaj përmbajtjes së transmetuar; Kualifikimet për Licencë të KPM-së; urdhrat e vlefshëm apo udhëzimet që Këshilli i KPM-së mund t’i aprovoj lidhur me veprimet apo sjelljet e të një licencuari; dhe të gjitha deklaratat tjera të të drejtave dhe obligimeve të subjekteve transmetuese në Kosovë të lëshuara nga KPM-ja apo PSSP-ja si dhe ato të shpallura nga Komisioneri i Përkohshëm për Media që mbesin në fuqi.

2.2 I Licencuar: I Licencuar do të thotë një subjekt transmetues i radios apo televizionit të cilit Komisioneri i Përkohshëm për Media apo agjencioni pasardhës i saj, KPM, i jep një licencë dhe përdorimin e frekuencës(ave) përcjellëse për transmetim. [Ngjashëm si në Pjesën e I-rë të Licencë]

2.3 Sanksione: Dënime financiare apo dënime tjera të lejuara për shkelje të rregulloreve të KPM-së sipas Ligjit për KPM-në dhe Transmetime.

3 Politikat e Përgjithshme:

3.1 Natyra progresive e sanksioneve: Përveç për shkelje të rënda të Rregulloreve, sanksionet në përgjithësi do të ndjekin një shkallë progresive, duke filluar me një Vërejtje për shkeljen e parë të një Rregullore të caktuar. Një apo më shume dënime në përgjithësi do t’i paraprijnë çfarëdo

suspendimi të licencës. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me një vendim paraprak të KPM-së apo përsëritja e shkeljeve të njëjta do të rezultojë në dënime më të ashpra, duke përfshirë dënime më të mëdha në rritje për shkelje të rregullores së njëjtë apo të barasvlershme të KPM-së.

3.2 Natyra proporcionale e sanksioneve: Sanksionet do të jene proporcionale me natyrën dhe më seriozitetin e një shkelje dhe më shkallën ekonomike të të licencuarit, dhe nuk do të jenë më të rëndë se sa të nevojshme për të parandaluar shkelje tjera dhe për të inkurajuar veprime përmirësuese nga ana e të licencuarit, duke marrë parasysh të gjithë faktorët relevant lehtësues apo rëndues.

3.3 Preferencë për veprime përmirësuese: Gjatë ndëshkimit të shkeljeve të rregulloreve të saja, KPM-ja do të synojë, kur do që të jetë e realizueshme, që të inkurajojë veprime përmirësuese, marrëveshje dhe profesionalizëm më të lartë nga të licencuarit.

4.0 Marrëveshjet: Një marrëveshje me një të licencuar është e përshtatshme kur i licencuari në bazë të vullnetit të tij pranon shkeljen dhe demonstroi një gatishmëri të besueshme për të ndërmarrë veprime përmirësuese si: trajnim të personelit, riorganizim apo nxjerrja e rregullave të brendshme të përcaktuara të parandalojnë kryerjen e shkeljeve të ngjashme në të ardhmen.

4.1 Pranimi i shkeljeve: Marrëveshjet kërkojnë një pranim të shprehur qartë të shkeljes nga ana e të licencuarit.

4.2 Gjobat e suspenduara: Një Marrëveshje mund të përshijë një dispozitë për pagim të një gjobe. Obligimi për të paguar nja gjobë mund të suspendohet për një kohë të kufizuar para se obligimi përfundon, në përgjithësi gjashtë muaj, në mungesë të shkeljeve shtesë të rregulloreve të KPM-së. Kryerja e shkeljeve të njëjta gjatë kohës kur është vendosur gjoba por është suspenduar me një Marrëveshje shkakton një obligim për të paguar dënimin e vendosur. Një Vendim i Këshillit mund të vë një dënim shtesë për shkeljen pasuese.

4.3 Veprimi përmirësues: Një Marrëveshje duhet të përcaktoj veprimin përmirësues të cilin i licencuari duhet ta ndërmerr.

4.4 Të dhënat disiplinore: Një rast i zgjidhur nëpërmjet një Marrëveshje me të cilën subjekti transmetues vepron në pajtueshmëri brenda afatit të Marrëveshjes nuk përbën një shkelje dhe nuk duhet që në përgjithësi të konsiderohet si pjesë e të dhënave disiplinore të të licencuarit. Mirëpo, KPM-ja

mund të merr parasysh faktet themelore të rastit të zgjidhur në vendimet rregullative në të ardhmen.

5.0 Konfiskimi i një pajisje: KPM-ja mund të urdhëroj konfiskimin e një pajisje vetëm për qëllim të dhënies fund të transmetimit të pa-licencuar. Një konfiskim i tillë do të jetë opsioni i fundit, nëse urdhrat e shkruara çartë për operuesin e një transmetuesi të pa-licencuar për të ndërprerë dhe larguar pajisjen e pa-licencuar dëshmojnë të jenë jo-efektive.

5.1 Konfiskimi do të jetë i kufizuar në minimumin e pajisjeve të domosdoshme për të arritur ndaljen e transmetimit ilegal. KPM-ja do t'i jep pronarit apo operuesit të një pajisje të tillë një Urdhër të vlefshëm për Konfiskim dhe një vërtetim për pajisjen, nëse identiteti i pronarit/operuesit mund të përcaktohet.

5.2 Pajisja e konfiskuar do të mbahet nga KPM-ja në një vend të sigurt, për t'iu rikthyer pronarit të saj të ligjshëm në momentin e garancive të kënaqshme se transmetimi ilegal nuk do të rishfaqet. KPM-ja mund të vendosë për një pajisje të tillë në përputhje me ligjin relevant.

6.0 Suspendimi i Licencës: KPM-ja do të suspendoj një licencë vetëm kur do të kryhen shkelje të rënda, të përsëritura apo të pandërprera të Rregulloreve. Çfarëdo veprimi i tillë do të jetë në përputhje me një qasje proporcionale dhe progresive ndaj sanksioneve.

6.1 Rrethanat për Suspendim të Licencës: Suspendimi i licencës mund të justifikohet me njërin nga rrethanat e më poshtme:

6.1.1 Vënia e mëhershme e gjobave të konsiderueshme (më shumë se dy) për shkelje të rregulloreve të KPM-së.

6.1.2 Mos pagesa e një gjobe në fuqi e KPM-së; kohëzgjatja e suspendimit do të jetë proporcionale me shkallën e gjobës së pa paguar.

6.1.3 Suspendimi i një kohëzgjatje të kufizuar dhe proporcionale në vend të vënies së ndonjë gjobe, nëse ka mjaft arsye për të besuar se i licencuari nuk do të jetë në gjendje që të paguaj gjobën.

6.1.4 Shkelje jashtëzakonisht serioze e Rregulloreve të KPM-së të cilat paraqesin kërcënim të çartë dhe të menjëhershëm për rendin publik.

6.2 Procedurat për suspendim të licencës:

- 6.2.1** Në të gjitha rastet, KPM-ja do të ofroj vërejtje me shkrim të qartë se suspendimi mund të urdhërohet. Vërejtja duhet të ofroj justifikime të qarta dhe të detajuara, të citoj rregullore të zbatueshme të KPM-së dhe do të ofroj një kohë të arsyeshme për subjektin transmetues për t'u përgjigjur dhe për të korrigjuar shkeljen në fjalë.
- 6.2.2** Këshilli i KPM-së do t'i ofroj të licencuarit një mundësi për një seancë dëgjimore para paraqitjes së Vendimit për Suspendim, përveç nëse Këshilli përcakton se serioziteti i shkeljeve është i tillë që vazhdimi i transmetimit paraqet një kërcënim të çartë dhe të menjëhershëm për rendin publik.
- 6.2.3** Në rrethana të një kërcënimi të çartë dhe të menjëhershëm për rendin publik, sipas këshillës së Shefit Ekzekutiv të KPM-së, Kryesuesi i Këshillit të KPM-së, në momentin e sigurimit të një miratimi të të paktën të tre anëtarëve tjerë të Këshillit, mund të lëshoj një Urdhër Emergjent për Suspendim të vlefshëm deri atëherë kur Kryesuesi i Këshillit përcakton se i licencuari nuk do të paraqes kërcënim për rendin publik. Ky veprim duhet të miratohet nga i tërë Këshilli sa më shpejtë që të jetë e mundshme.

7.0 Revokimi i Licencës: Revokimi i licencës mund të justifikohet me njërin nga rrethanat si në vijim:

7.1 Përfundim Vullnetar i transmetimit me njoftim të KPM-së: Një i Licencuar që vullnetarisht përfundon operimet e tij dhe njofton për këtë KPM-në do të konsiderohet se vullnetarisht e ka dorëzuar licencën e tij. Me të marrë një njoftim të tillë KPM-ja do ta konsideroj licencën të jetë e pavlefshme dhe të anuluar. Personeli i KPM-së do ta këshilloj Këshillin, i cili do ta lëshoj një Urdhër për Revokim të licencës pa paragjykuar në ndonjë aplikacion të ardhshëm për licencë të cilin i licencuari mund ta paraqes.

7.2 Ndërprerja e Transmetimit pa Njoftuar KPM-në: KPM-ja mund ta revokoj licencën nëse përcakton se i licencuari i kishte ndërprerë, e jo thjeshtë suspenduar, operimet e tij pa dërguar njoftim për ndërprerje të KPM-ja. Ndërprerja është definuar si njëra prej pikave në vijim përveç ndaljes së transmetimit: (a) ndërprerje e marrëdhënies së punës të gjithë personelit për të operuar më stacionin ku i njëjti personel është punësuar më herët; (b) anulim i regjistrimit të biznesit; (c) heqja e premisave dhe/apo pajisjeve për transmetim.

7.3 Dështimi për të përdorur Licencën: Dështimi nga i Licencuari apo Aplikuesi për të shfrytëzuar plotësisht apo në vazhdimësi licencën e dhënë më

herët nga KPM-ja mund të merret si një dëshmi për mos aftësi për të menaxhuar dhe mbajtur një operim profesional të transmetimit, dhe mund të rezultojë në anulim të licencës. Një dështim i tillë mund të definohet si dështimi për të filluar me transmetim brenda kohës të përcaktuar në licencë, dështimi i vazhdueshëm për të transmetuar minimumin e orëve të kërkuar në licencë apo ndërprerja e stërzgjatur apo e madhe e transmetimit, përveç nëse pengesat e tilla vijnë si rezultat i *force majeure*.

7.3.1 Ndërprerjet e stërzgjatura: Gjashtëdhjetë (60) ditë në vazhdimësi të ndërprerjes së transmetimit për arsye tjera nga *force majeure*, apo 90 ditë jo në vazhdimësi brenda një periudhe gjashtë mujore, e kombinuar me dështimin për të paraqitur një plan të besueshëm për KPM-në për vazhdim të transmetimit definohet si ndërprerje e stërzgjatur. Një ndërprerje e tillë do të merret për të treguar paaftësinë e mundshme të të licencuarit për të operuar më një stacion transmetimi me standardet minimale të profesionalizmit. KPM-ja do ta njoftoj të licencuarin se licenca e tij mund të anulohet për Dështim për ta Shfrytëzuar, dhe do të lejoj të paktën 14 ditë për të licencuarin për t'u përgjigjur me një plan të besueshëm për vazhdim të transmetimit dhe të dëshmoj arsyen se pse licenca nuk duhet revokuar.

7.3.2 Transmetim i çrregullt e i stërzgjatur: Pengesat madhore të përsëritura në, apo ndryshimet e mëdha të, kohës ditore të transmetuar që nuk kanë të bejnë me *force majeure*, gjatë një kohe prej 60 ditë apo më shumë. Ndërprerje të tilla do të merren për të treguar paaftësinë e mundshme të të licencuarit për të operuar më një stacion transmetimi me standardet minimale të profesionalizmit. KPM-ja do ta njoftoj të licencuarin se licenca e tij mund të revokohet për Transmetim të Çrregullt dhe të stërzgjatur, dhe do të lejoj të paktën 14 ditë për të licencuarin për t'u përgjigjur me një plan të besueshëm për vazhdim të transmetimit dhe të dëshmoj arsyen se pse licenca nuk duhet revokuar.

7.3.3 Dështimi në vazhdimësi për të shfrytëzuar minimalisht licencën: Dështimi për të shfrytëzuar minimalisht një frekuencë të licencuar për transmetim siç është përcaktuar në licencën e KPM-së për një periudhë prej 60 ditë apo më shumë, apo 90 ditë në një periudhë gjashtë mujore, për arsye jo të lidhura me shkaktarë të jashtëm do të jetë një bazë për revokim të licencës. KPM-ja do ta njoftoj të licencuarin se licenca e tij mund të revokohet për mos aftësi të shfrytëzimit të frekuencës, dhe do t'i lejoj të paktën 14 ditë të licencuarit për t'u përgjigjur më një plan të besueshëm për vazhdim të transmetimit dhe të dëshmoj arsyen se pse licenca nuk duhet revokuar.

- 7.3.4 Suspendimi i dytë i licencës:** Shkeljet e përsëritura apo të vazhdueshme të rregulloreve të KPM-së të cilat do ta justifikonin suspendimin e dytë brenda periudhës dy vjeçare mund të shërbejnë si baza për revokim të licencës.
- 7.3.5 Shkelje jashtëzakonisht e madhe e Rregulloreve të KPMs-së:** (1) dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me një urdhër për suspendim; (2) kryerja e një shkelje rregullative e cila qartë inkurajon apo rezulton në një akt të çrregullimit të rendit publik do të konsiderohen si baza për revokim të licencës.
- 7.3.6 Dështimi për t'i përmbushur Kualifikimet e KPM-së për Licencë:** një i licencuar i cili në mënyrë të pavërtetë dhe mashtruese pohon pajtueshmëri me Kualifikimet e KPM-së për Licencë mund ta ketë licencën e tij të revokuar me tu dëshmuar një pavërtetësi apo mashtrim i tillë. Një i licencuar të cilit statusi apo rrethanat i ndryshojnë ashtu që ta bijën të licencuarin jo në përputhje me Kualifikimet e KPM-së për Licencë mund ta ketë licencën e tij të revokuar nëse dështon, gjatë një kohe të arsyeshme, për t'i korrigjuar rrethanat diskualifikuese. Para revokimit të licencës në rrethana të tilla, KPM-ja do t'i ofroj të licencuarit të paktën 60 ditë për të kërkuar miratimin e KPM-së për shitje apo transferim tjetër të licencës tek një i licencuar i kualifikuar apo përndryshe të korrigjoj diskualifikimin.
- 7.3.7 Shitja e paautorizuar e një subjekti transmetues:** Licenca mund t'i revokohet nëse një subjekt transmetues është shitur apo transferuar tek një palë e tretë në shkelje të kushteve të licencës.
- 7.3.8 Nevoja e Interesit Publik në Konkurs:** Në rrethana të veçanta, KPM-ja mund të përcaktoj se shitja apo transferimi i nja subjekti transmetues tek një i licencuar i propozuar nuk është në interes të publikut. Në raste të tilla, KPM-ja mund të hapë një konkurs publik për frekuencën(at) relevante në të cilin blerësi i propozuar apo pranuesi i transferit mund të konkurroj pa paragjykimë. Më tu dhënë konkursi, licenca origjinale do të revokohet.

8.0 Procedurat për revokim të licencës: Në të gjitha rastet, KPM-ja do të ofroj vërejtje shpjeguese të qartë se revokimi mund të urdhërohet, dhe do të ofroj një kohë të arsyeshme për të licencuarin për t'u përgjigjur dhe për të korrigjuar çështjet në fjalë.

- 8.1** Në të gjitha rastet e propozuar për revokim të licencës, KPM-ja do të ofroj vërejtje me shkrim të qartë se revokimi mund të urdhërohet. Vërejtja duhet të ofroj justifikime të qarta dhe të detajuara, të citoj

rregullore të zbatueshme të KPM-së dhe do të ofroj një kohë të arsyeshme për subjektin transmetues për t'u përgjigjur.

- 8.2** Këshilli i KPM-së do t'i ofroj të licencuarit një mundësi për një seancë dëgjimore para dhënies së Vendimit për Revokim.

#